

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Në
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919812/video-shkullaku-rama-e-nisi-me-krimin-dhe-po-e-mbyll-me-te-shqiptaret-kane-te-drejte-te-reagojne/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 20:59:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 19:53:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	73636a3d9898ce58477b4a4e3fe86e314532e11541f9bc00f54099919af18df
TEKSTI	e942a37defdc3d9d02c89b865cafee89d396bd8527eb2504f1a377c8258ae90b
PAMJA	f96879ccbb260ee5656416198a532bc1c9174f9b4c2fb106606518bc820b5f81

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	82fd17a5bb752bc1f0682c4cafd90d12f1e5aaa1ef1f993b2acf196318726b9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	81d9502dee89498020984867f5c9e7803768541a0034d6fb041c0efcf168cb37
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/82fd17a5bb752bc1f0682c4cafd90d12f1e5aaa1ef1f993b2acf196318726b9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




ÇIM PEKA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk i kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



VIDEO/ Shkullaku: Rama e nisi me krimin dhe po e mbyll me të, shqiptarët kanë të drejtë të reagojnë

21:53, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Gazetari Armand Shkullaku, i ftuar në 'Çim Peka LIVE' në SYRI TV, ka bërë deklarata të forta për situatën politike në vend, duke e lidhur qeverisjen e Edi Ramës me çështje që, sipas tij, kanë në qendër krimin dhe kapjen e institucioneve.

Duke iu referuar fillimit të qeverisjes së Ramës dhe çështjes së kanabizimit, Shkullaku tha se historia është duke u mbyllur sërish me çështjen e radarëve dhe kontrabandës.

Sipas tij, e njëjta histori po përsëritet edhe në fund të qeverisjes.

Duke folur për institucionet dhe çështjet që lidhen me drejtues të lartë të shtetit, Shkullaku tha se, sipas tij, zhvillimet e fundit tregojnë një dobësim të rëndë të funksionimit institucional.

'Domethënë në mandat të 4-të nuk e mban dot pa krimin me të cilin e nisi, dhe me atë po e përfundon. Fillimi i historisë kanë qenë radarët e Saimit Tahirit që raportonte SHISH i asaj kohe, po e mban mend, ka pasur një raport për kanabizimin e Shqipërisë dhe Rama e hoqi, eliminoi drejtuesin e atëhershëm.

Dhe po e mbyll po prapë me fikjen e radarëve për kontrabandën e cigares apo për elementë të tjerë. Pra, këtu ky, për mua kapitull mbyllet.

Çështja tani është që, në rast se para shqiptarëve nuk ka ngelur më, mendoj unë, qelizë e organizatës së Rilindjes e painfektuar. Pra, përballë këtij infeksioni, çështja është, do vazhdojmë të mpihemi dhe të kalbemi nga ky qelb, apo shoqëria do marrë iniciativë diçka në dorë.

Në qoftë se deri dje çdo thirrje për radikalizëm, çdo thirrje për të marrë situatën në dorë, çdo thirrje për mosbindje qytetare e të tjerë e të tjerë, me të drejtë mund të shikohet me rezervë, sepse ka rrugë të tjera, sot mendoj unë, në qoftë se ka një popull në botë që ka të drejtën legjitime të bëjë çfarë të dojë kundër qeverisë së vet, është populli shqiptar. Sepse ja kanë kapur të gjitha.

Domethënë se nuk dua të flas për Këshillin e Sigurimit, që e shtrova në fillim se është qesharake të thuash që ka kapur dhe Këshillin e Sigurimit Kombëtar. Diku

më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



'Rama padrino i Tahirrit, Veliajt, Ballukut, Gysit, Vlorës'/ Bushati: Funksionimi i shtetit si bandë mafioze



Skandali i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



sikur që ka kapur se dihet kush është. Ai mund të kapë dhe Keshillin e Sigurimit të OKB-së, siç ka kapur shefin e kundërzbulimit të FBI-së e të tjerë.

Por Këshilli i Sigurimit nuk është gjë tjetër, veçse tregon edhe një herë para shqiptarëve që këtu nuk ka më shtet, pra, i lind e drejta çdo qytetari të veprojë vetë nesër. Pse?

Bajromi thotë atë që ka thënë ai. kryeprokurori ulet përballë njeriut që e di që është i inkriminuar, se i del në dosje. Çdo komunikim ata e kanë, pavarësisht se është kryeministër, ka imunitet ata, i ruajnë. Kanë në krah edhe vetë presidentin e Republikës, që SPAK duhet ta marrë pajetër të pandehur, kur ka qenë komandant i forcave të përgjithshme, ka firmosur nga Shëngjini, ka bërë investim, kolegu im Ferdinand Dervishi, fantastik se si ky ka vepruar kundër ligjit në planin e përhapjes duke nxjerrë objektet e ushtrisë për t'ia dhënë bizneseve të ndryshme. Pra, edhe ai është i inkriminuar, prandaj është aty.

Pra, nuk ka asnjë drejtues shteti që Rama e ka vënë në pozicione decizive vendimmarrëse (për një shtet flasin ë), që nuk ka një element inkriminimi që varet nga kreu i organizatës.

Pra, mbasi ke bërë vrasjen e parë, ti pranohesh në organizatë. Përndryshe nuk mund të jesh në organizatë, edhe i ndershëm. Këtu, mendoj unë, përveç shoqërisë që thashë, ka çdo të drejtë, se mbas kësaj mbyllet historia, pra: Edi Rama është kreu i një organizate kriminale, ose është idiot. Unë mendoj që është e para.

Dhe e dyta, përveç shoqërisë që i lind çdo e drejtë të reagojë me çdo lloj forme ndaj një bande që i ka marrë peng vendin, mendoj që... e di që është një kështu si thirrje shkretëtirë, po... mendoj që duhet të ketë disa njerëz brenda Partisë Socialiste... nuk po them të bëjnë ndonjë akt trimërie, as të flasin, as të denoncojnë, por mund të thonë vetëm një fjali shumë të thjeshtë: 'Partia Socialiste nuk është Ergys Agasi'. Kaq.

Ose 'Ergys Agasi nuk përfaqëson mazhorancën...' As këtë nuk e thonë dot! Më kupton? Dhe në këtë aspekt, biles unë për ca, kam më tepër respekt për ca figura që ngjallin shumë urrejtje te njerëzit, po themi Taulant Balla, Belinda Balluku që dalin hapur.

Po të paktën ata e kanë marrë, të paktat i kanë vënë vetë në fytyrë, i kanë dalë me fytyrë, kanë marrë përgjegjësi morale, politike, dhe ligjore ndoshta. Sesa disa të tjerë që nëpër tavolina... pfff... 'nuk bëhet, s'e bëri ky Rama, e ka kriminalizua komplet, bëri ligjin për këtë Agasin, na ka fut gjithë këtë në parlament' dhe ulin kokën aty dhe mbarojnë ato punët e vogla brenda Ramës.

Kupton apo jo? Njëri rregullon gruan, rregullon çunin... Pra, këta janë më të këqijtë brenda organizatës, për mua. Kështu që çështja, mbas kësaj që ka ndodhur, nuk është më 'a e dinte Rama', se kjo është domethënë sfidë që na i bëhet inteligjencës tonë, 'a e dinte Rama'.

Më kupton? Këtu s'jemi sfiduar vetëm ne, këtu është sfiduar, se ai thotë, partnerët të tanë u tronditën nga kjo gjë.', u shpreh ndër të tjera Armand Shkullaku në SYRI TV.

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO-Deklarata e Ramës/ Buzhala: A ka marrë lek a nuk ka marrë, këtë e vendos dikush tjetër



'Zyra e Agasit si 'Mekë' e pushtetit', Vangjeli: Aty parakaluan politikanë e gjyqtarë të Kushtetueses



Mbyllet protesta e 121-të, protestuesit: Nuk do të ndalemi

Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



VIDEO/ Shkullaku: Rama e nisi me krimin dhe po e mbyll me të, shqiptarët kanë të drejtë të reagojnë



Arrestimi i Vlora Hysenit/ Ish-ministri i Ramës: Vartësit imitojnë shefin e tyre, e sillen si ai

TË NGJASHME



'Kama padirino i tanirrit, veniajt,
Ballukut, Gysit, Vlorës// Bushati:
Funksionimi i shtetit si bandë mafioze



'Rama në burg'/ Protestuesit nisin
marshimin pas fjalimeve në protestën
e 121-të

'O me kamen, o me snqiptaret',
aktivisti: Shoqëria civile, akademikët
dhe kleri të mos heshtin!



VIDEO/ Bajaziti: Rama e ka
shndërruar komunikimin publik në
qesharak, kërkon nga Europa të mos e
lërë në baltë

Kama zduket nga VIDEO zyrtare e
OKB-së/ Zhupa: Foto e kryeministrit
nuk shfaqet mes liderëve



FOTO/ Pankartat: Këshilli i Sigurisë,
shumë karrige, shumë fjalë, po
përgjegjësia ku ka për të dalë?

VIDEO/ 1 nirtja ne proteste: Ne s
tetor studentët ngrihen në protestë
kundër Edi Ramës dhe qeverisjes së
tij

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staffi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net